

TOP CHANNEL Sh.a

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR	I,II
PASQYRAT FINANCIARE :	
PASQYRA E KONSOLIDUAR POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E KONSOLIDUAR E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E KONSOLIDUAR E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	4
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	5-31



BAKER TILLY ALBANIA

Rr.Themistokli Gërmenji, Nr.2
Pall.Ambasador 1, 3-rd floor
Tirana
Albania

T: +355(0)42232726

office@bakertillyalbania.com
www.bakertillyalbania.com

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë Top Channel ShA. (me poshtë referuar si “shoqëria”), te cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar te pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2016, pasqyrën e konsoliduar te fitim ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar te ndryshimeve në kapital, pasqyrën e konsoliduar te flukseve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë si dhe shënimet shpjeguese te pasqyrave financiare, duke përfshirë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale gjëndjen financiare të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2016, rezultatin financiar dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare te Raportimit Financiar (“SNRF”).

Baza për Opinion

Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNAs). Përgjegjësia jone sipas këtyre standardeve përshkruhet në vijim në seksionin e raportit tonë. Përgjegjësia e audituesve për auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe i kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësia e Drejtimit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë nga mashtrimi apo pasaktësia.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar në kushtet e vijimësisë së biznesit, zbulimin, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me vijimësinë dhe përdorimin e bazës së vijimësisë të kontabilitetit, përveç rasteve kur drejtimi synon të likuidojë Shoqërinë ose të pushojë veprimtarinë, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër realiste përveç kësaj.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë dhënia e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë pa gabime materiale, qoftë nga mashtrimi apo pasaktësia, dhe dhënia e raportit të audituesve që përfshin opinionin tonë. Siguri e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk është një garanci që një kontroll i kryer në përputhje me SNA gjithmonë do të zbulojë një anomalë materiale, kur ajo ekziston. Anomalitë mund

të lindin nga mashtrimi apo pasaktësia dhe konsiderohen si materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato pritet që të ndikojnë vendimet ekonomike të marra nga përdoruesit mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo pasaktësive, planifikojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit, që u përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi, që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për bazat e opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një keq deklarimi material, që vjen nga mashtrimi është më i lartë se ai që vjen nga gabimet, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, mos përfshirje të qëllimshme, keq paraqitje, apo tejkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit, që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të njësisë ekonomike.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shënimeve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga drejtimi të parimit të vijimësisë në kontabilitet dhe, duke u bazuar në evidencën e marrë gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose rrethanat që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi aftësinë e njësisë ekonomike për të vazhduar në kushtet e vijimësisë së biznesit. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit për paraqitjen e këtij informacioni në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, nëse këto shënime janë të papërshtatshme, për të modifikuar opinionin tonë.
- Në rastet e një misioni për auditimin e një grupi, marrim evidenca auditimi, që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënat financiare të njësive ekonomike ose aktiviteteve tregtare brenda grupit për të shprehur një opinion për pasqyrat financiare të grupit. Ne jemi përgjegjës për drejtimin, mbikëqyrjen dhe cilësinë e auditimit të grupit. Ne jemi të vetmit përgjegjës për opinionin e auditimit.

Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarje ose rrethana në të ardhmen mund të detyrojnë njësinë ekonomike të mos vazhdojë më në kushtet e vijimësisë së biznesit.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje në lidhje me, midis çështjeve të tjera, qëllimin e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Midis çështjeve që ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë, nëse ka, ato çështje që kanë qenë më të rëndësishmet për auditimin e pasqyrave financiarë të periudhës aktuale dhe rrjedhimisht janë çështje kryesore auditimi. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin tonë të auditimit përveç rasteve kur ligjet apo rregulloret e ndalojnë paraqitjen publike të çështjes ose kur, në raste shumë të rralla, ne vendosim që një çështje nuk duhet komunikuar në raportin tonë të auditimit sepse ndikimi negativ që do kishte, do të tejkalonte mjaftueshëm përfitimet e interesit publik të këtij komunikimi.

Baker Tilly Albania shpk.
Elton Haxhi
Auditues Ligjor

Tiranë

14 Prill 2017



Pasqyra e konsoliduar e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2016

	Shënime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
AKTIVE			
Aktivitet afatgjata			
Aktivitet afatgjata materiale dhe jomateriale	5	2,118,913,338	2,321,160,961
Llogari të arkëtueshme të tjera	6	15,416,139	4,439,936
Pjesëmarrje në njësi	7	9,053,928	5,079,360
Totali i aktiveve afatgjata		2,143,383,405	2,330,680,257
Aktivitet afatshkurtra			
Inventarë	8	3,167,649	2,651,455
Llogari të arkëtueshme tregtare	9	609,716,665	579,721,500
Llogari të arkëtueshme të tjera	10	3,730,268	24,378,836
Parapagime për furnizimet	11	1,261,040	643,710
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	12	61,861,277	107,792,233
Mjetet monetare në arkë e në bankë	13	6,690,523	9,921,903
Totali i aktiveve afatshkurtra		686,427,422	725,109,637
Totali i aktiveve		2,829,810,827	3,055,789,894
KAPITALI			
Kapitali aksionar		525,400,000	525,400,000
Rezerva të tjera		333,524,410	208,409,702
Rezerva ligjore		10,522,375	10,484,721
Fitime të mbartura		-	124,399,269
Rezerva për kthimin		940,436	546,264
Fitimi i ushtrimit		1,152,748	753,094
Totali i kapitalit	14	871,539,969	869,993,050
DETYRIMET			
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	15	465,241,955	636,550,907
Grante, të ardhura të shtyra e të tjera detyrime	16	6,753,578	7,109,029
Detyrime të tjera afatgjata	17	123,535,898	40,637,846
Totali i detyrimeve afatgjata		595,531,431	684,297,782
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	18	374,152,418	406,887,930
Llogari të pagueshme tregtare	19	808,022,318	849,657,552
Parapagimet e arkëtuara	20	153,008,194	205,633,728
Grante, të ardhura të shtyra e të tjera detyrime	16	355,451	374,159
Llogari të pagueshme të tjera	21	27,201,046	38,945,693
Totali i detyrimeve afatshkurtra		1,362,739,427	1,501,499,062
Totali i detyrimeve		1,958,270,858	2,185,796,844
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		2,829,810,827	3,055,789,894

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 5 -31, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

**Pasqyra e konsoliduar e Fitim ose Humbjes dhe të të ardhurave gjithpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	22	1,492,655,053	1,646,341,166
Të ardhura të tjera	23	101,092,403	973,313
Total të ardhura		1,593,747,456	1,647,314,479
Materiale dhe shërbime direkte	24	(522,806,482)	(527,395,568)
Shpenzime personeli	25	(684,543,020)	(741,205,545)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	26	(281,100,783)	(300,539,912)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	27	(55,128,661)	(21,922,859)
Total shpenzime		(1,543,578,946)	(1,591,063,884)
Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)	28	(51,035,583)	(67,560,415)
Te ardhura të tjera financiare (neto)	29	11,909,975	20,337,986
Fitimi/humbja para tatimit		11,042,902	9,028,166
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(9,890,154)	(8,275,072)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(9,652,479)	(8,275,072)
Zbritje tatim fitimi		(237,675)	-
Fitimi/humbja e vitit	30	1,152,748	753,094
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin			
Diferenca (+/-) nga perkthimi i monedhes ne veprimtarite e huaja		394,172	546,264
		394,172	546,264
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		1,546,920	1,299,358

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 5 - 31, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Top Channel sh.a

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e konsoliduar ndryshimeve në Kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Kapitali aksionar	Rezerva përkthimi	Rezerva ligjore	Rezerva te tjera	mbartura/humbje të akumuluar	Fitim (Humbje) Ushtrimit	Totali
Pozicioni financiar më 01 janar 2015	525,400,000	-	10,323,329	205,343,259	124,399,269	3,227,835	868,693,692
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse të periudhës/vitit:							
Fitim/Humbja e vitit	-	-	-	-	-	753,094	753,094
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse	-	546,264	-	-	-	-	546,264
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	546,264	-	-	-	753,094	1,299,358
Transaksione me pronaret e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:							
Transferimi i fitimit të vitit 2014	-	-	161,392	3,066,443	-	(3,227,835)	-
Totali i transaksioneve për pronaret e njësisë ekonomike	-	-	161,392	3,066,443	-	(3,227,835)	-
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2015	525,400,000	546,264	10,484,721	208,409,702	124,399,269	753,094	869,993,050
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse të periudhës/vitit:							
Fitim i vitit	-	-	-	-	-	1,152,748	1,152,748
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	394,172	-	-	-	-	394,172
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	394,172	-	-	-	1,152,748	1,546,920
Transaksione me pronaret e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:							
Transferim i fitimit të vitit 2015	-	-	37,654	715,440	-	(753,094)	-
Transferimi i fitimit të akumuluar	-	-	-	124,399,269	(124,399,269)	-	-
Totali i transaksioneve për pronaret e njësisë ekonomike	-	-	37,654	125,114,709	(124,399,269)	(753,094)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	525,400,000	940,436	10,522,375	333,524,411	-	1,152,748	871,539,970

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 5 – 31, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Administratori i Top Channel sh.a më 30 mars 2017 dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:

MAZARS
Rrethim i "Kujteshës"
No.3, 10000 Tiranë, Shqipëri
Phone: +355 22 27 80 15
www.mazars.al, info@mazars.al

MAZARS shp.k
Hartues i Pasqyrave Financiare

Z. Yjollca Hoxha
Z. Yjollca Hoxha
Drektore e Përgjithshme

Pasqyra e konsoliduar Fluksit të Mjeteve Monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	11,042,902	9,028,166
Axhustime për zërat jo-monetare:		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	203,435,154	194,310,015
Rimarrje amortizimi nga grantet	(374,159)	(346,003)
Provizione për zhvlerësimin e klienteve	15,500,000	20,000,000
Kuota pjese për tu shperndare	62,165,629	86,827,453
Nxjerrja jashtë përdorimit e AAM-ve neto	27,906,479	(253,676)
Shpenzime për interesa	51,035,583	67,560,415
Diferenca konvertimi nga perkthimi	414,395	587,392
Fitimi operativ përpara ndryshimeve në kapitalin qarkullues	371,125,983	377,713,762
Ndryshimi në kapitalin qarkullues		
Ndryshimi në inventar	(516,194)	(1,976,017)
Ndryshimi në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	(35,822,800)	(81,083,697)
Ndryshimi në llogari të pagueshme dhe të tjera	(103,139,124)	342,564,072
Ndryshimi në parapagime e shpenzime të shtyra	(16,852,003)	(75,405,287)
Ndryshimi në grante dhe të ardhura të shtyra	-	(4,166,667)
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	(156,330,121)	179,932,404
Interesa të paguara	(50,941,342)	(67,379,520)
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	(12,850,683)	(1,841,761)
	(63,792,025)	(69,221,281)
Aktivitetet investuese		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale	(29,114,233)	(430,887,847)
Shitje e aktiveve afatgjata materiale	-	2,778,071
Dalja për parapagime për asete	(3,974,568)	(5,079,360)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues	(33,088,801)	(433,189,136)
Aktivitetet financuese		
(Ripagim)/ të hyrat neto nga huatë afatgjata	(1,639,273,338)	(1,902,042,796)
(Ripagim)/ të hyra nga hua afatshkurtër	1,518,126,923	1,843,046,078
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues	(121,146,416)	(58,996,718)
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	(3,231,380)	(3,760,969)
Mjetet monetare në fillim të periudhës	9,921,903	13,682,872
Mjetet monetare në fund të periudhës	6,690,523	9,921,903

13

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 5 – 31, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

1. Informacion i përgjithshëm

Top Channel sh.a. ("Shoqëria") është një kompani aksionere, e cila është krijuar në vitin 2001 me vendim gjykatë Nr. 25561 datë 29.03.2001. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i saj. Adresa e selisë së shoqërisë është Rruga 17 Nentori, Godina nr.2 Kashar.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është në fushën e veprimtarisë televizive kombëtare që përfshin prodhimin, transmetimin e programeve të informacionit të çdo lloji me anë të zërit dhe figurës, sinjaleve të koduara, dhe shkrimit të destinuar për publikun.

Veprimtaria radiotelevizive zhvillohet në përputhje me ligjin nr. 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, me dispozitat e ligjit Nr. 8410, datë 30.9.1998 PËR RADION DHE TELEVISIONIN PUBLIK E PRIVAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Pasqyrat financiare janë të konsoliduara duke përfshirë Pasqyrat financiare Top Channel Tiranë, dega Top Channel në Kosovë dhe dega e Top Channel në Maqedoni.

Perfaqësues Ligjor i shoqërisë Top Channel sh.a është znj. Vjollca Hoxha.

Shoqëria më 31 dhjetor 2016 kishte 555 punonjës të regjistruar (31 dhjetor 2015: 596).

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

2.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme janë efektive për periudhat e raportimit financiar që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2016.

- *Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara", SNRF 12 "Dhënia e informacioneve shpjeguese në lidhje me interesat në njësitë e tjera ekonomike" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta" - Njësitë investuese: Aplikimi i përjashtimit të konsolidimit - miratuar nga BE-ja më 22 shtator 2016 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016)*
- *Ndryshimet në SNRF 11 "Marrëveshje të përbashkëta" Kontabiliteti për Blerjet e interesave në operacione të përbashkëta - të miratuar nga BE-ja më 24 nëntor 2015 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016)*
- *Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e pasqyrave financiare" Paraqitja Fillestare - miratuar nga BE-ja më 18 dhjetor 2015 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016)*
- *Ndryshimet në SNK 16 "Aktivet Afatgjata Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje)" - Sqarimi i Metodave të pranueshme të Zhvlerësimit dhe Amortizimit - të miratuara nga BE-ja më 2 dhjetor 2015 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016).*
- *Ndryshimet në SNK 27 "Pasqyrat financiare individuale" - Metoda e kapitalit neto në pasqyrat financiare të veçanta - e miratuar nga BE-ja më 18 dhjetor 2015 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016)*
- *Ndryshimet në standardet e ndryshme "Përmirësimet në SNRF-të (cikël 2012-2014)" që rezultojnë nga projekti për përmirësimin vjetor të SNRF (SNRF 5, SNRF 7, SNK 19 dhe SNK 34) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin - miratuar nga BE-ja më 15 dhjetor 2015 (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016).*

Miratimi i këtyre ndryshimeve në standardet ekzistuese nuk ka çuar në ndonjë ndryshim material në pasqyrat financiare të kompanisë.

2.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuar

Në datën e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e mëposhtme, interpretimet dhe rishikimet janë emetuar por nuk janë ende efektive:

- SNRF 9 "Instrumentat Financiar" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018)
- SNRF 15 "Të ardhurat nga Kontratat me Klientet" dhe amendime të mëtejshme (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018)
- SNRF 16 "Qirate" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2019)
- Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesat e bazuara në aksione" (Klasifikimi dhe matja e pagesës të bazuar në aksione (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018).
- Ndryshimet në SNRF 4 "Kontratat e Sigurimit"- Aplikimi i SNRF 9 "Instrumentat Financiar" me SNRF 4 "Kontratat e Sigurimit" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 Janari 2018 ose kur SNRF 9 "Instrumentat Financiare aplikohet për herë të parë).
- Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrjet dhe në sipërmarrjet e përbashkëta"- Shitja ose Kontributi aseteve ndërmjet një investitori dhe ortakut ose sipërmarrjet e përbashkëta dhe ndryshime të mëtejshme (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018)
- Ndryshimet në SNK 7 "Pasqyra e Flukseve Monetare"- Paraqitja fillestare (efektive për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 Janari 2017)
- Ndryshimet në SNK 12 "Tatimi mbi të ardhurat"- Njohja e detyrimeve tatimore të shtyrë për humbjet e parealizuar (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2017)
- Ndryshimet në SNK 40 "Aktivet Afatgjata Materiale të Investuara"- Transferimet e aktiveve afatgjata materiale të investuara (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018)
- Ndryshime të standarteve të ndryshme "Permiresime të SNRF-ve (cikli 2014-2016)" që rrjedhin nga projekti vjetor i permiresimit të SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 12, IAS 28) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (Ndryshimet në SNRF 12 duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017 dhe ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28 duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018)

Kompania ka zgjedhur të mos i përvetësojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datës që ato do të bëhen efektive. Kompania parashikon se përvetësimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar të tyre.

3. Bazat e përgatitjes

3.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare janë paraqitur të konsoliduara për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2016 duke përfshirë edhe degën e Kosovës dhe Maqedonisë.

3.2. Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") të BSNK-se.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë.

3.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

3.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

3.5. Bazat e konsolidimit

Degët janë të gjitha subjektet (duke përfshirë njësitë ekonomike për qëllime të veçanta) mbi të cilat Grupi ka fuqi për të qeverisur politikat financiare dhe operative, që në përgjithësi u atribuohen aksionereve që zotërojnë më shumë se gjysmën e të drejtave të votës. Ekzistenca dhe efekti i të drejtave votuese potenciale që janë aktualisht të ushtrueshme ose të konvertueshme janë konsideruar kur është bërë vlerësimi nëse Grupi kontrollon një njësi tjetër ekonomike. Filialet janë konsoliduar plotësisht që nga data në të cilën kontrolli i është transferuar Grupit. Metoda e koston është përdorur për të kontabilizuar blerjen e filialeve nga Grupi. Kostoja e blerjes është matur në vlerën e drejtë të aktiveve të dhëna, instrumentave të kapitalit neto të emetuara dhe detyrimeve të pësura ose konstatuara në datën e këmbimit, plus kostot direkte të blerjes. Aktivitetet e identifikueshme të blera dhe detyrimet e konstatuara në një kombinim biznesi njihen fillimisht me vlerën e drejtë në datën e blerjes, pavarësisht nga interesi i pakicës. Tejkalimi i koston së blerjes mbi vlerën e drejtë të pjesës të grupit të aktiveve neto të identifikueshme njihet si emri i mirë. Transaksionet midis shoqërive të grupit, balancat dhe fitimet e përealizuara për transaksione ndërmjet shoqërive të grupit janë eliminuar. Gjithashtu janë eliminuar humbjet e përealizuara. Politikat kontabël të filialeve janë ndryshuar kur ka qene e nevojshme për t'u përputhur me politikat e miratuara nga Grupi.

3.6. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

3.6.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e klientëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të klientëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së klientëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

3.6.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3.6.3 Zhvlerësimi i inventarëve

Shoqëria vlerëson gjendjen e inventarit në qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera, me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit, bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe në llogaritjen e vlerës neto të realizueshme. Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është më e ulët se vlera kontabël neto, ekziston një tregues që inventari është i zhvlerësuar. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

4. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
EUR/LEK	135.23	137.28
USD/LEK	128.17	125.79
CHF/LEK	126.05	126.74
GBP/LEK	157.55	186.59

4.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Per llogarite e pagueshme ,te pa paguara dhe te pa kërkuara per me shume se pese vjet per te cilat shoqëria bazuar ne te dhënat dhe komunikimin me palën tjetër nuk ka ndonjë pritshmëri per shlyerjen e këtyre detyrimeve, gjykon se detyrimet e me sipërme nuk duhen njohur si te tilla por i njeh si të ardhura te vitit qe vijne nga fshirja e tyre.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivët financiarë të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(Vlerat janë në Lek)

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4.2. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

4.3. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Normat e amortizimit për vitin 2016 dhe 2015 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Toka	-	Nuk amortizohet
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Instalime Teknike	Vlera e mbetur	20%
Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Te tjera	Vlera e mbetur	20%

Vlera e mbartur e aktiveve afatgjata materiale rishikohen për zhvlerësim kur ngjarje apo ndryshime në rrethanat tregojnë se vlera kontabël mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, kur vlera kontabël tejkalon vlerën e rikuperueshme të vlerësuar aktivet paraqiten me vlerën e tyre të

(Vlerat janë në Lek)

rikuperueshme, e cila është më e larta mes vlerës së tyre të drejtë minus kostot për shitje dhe vlerës së tyre në përdorim.

Amortizimi nuk aplikohet për tokën dhe punimet në proçes që nuk janë në funksionim.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.4. Aktivet Afatgjata Jomateriale

Një aktiv jo-material njihet nëqoftëse, e vetëm nëqoftëse:

është e mundur që përfitimet e pritshme ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktiv do të rrjedhin tek njësia ekonomike; dhe kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri.

Një njësi ekonomike vlerëson mundësinë e përfitimeve të pritshme ekonomike në të ardhmen duke përdorur supozime të arsyeshme dhe të mbështetura që përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të drejtimit të kompletit të kushteve ekonomike që do të ekzistojnë gjatë jetës së dobishme të aktivit.

Njësia ekonomike përdor gjykimin për të vlerësuar shkallën e sigurisë bashkëngjitur flukseve të përfitimeve ekonomike në të ardhmen që i atribuohen përdorimit të aktivit mbi bazën e evidencës së disponueshme në kohën e njohjes fillestare, duke i dhënë më shumë rëndësi evidencës nga të tretët.

Një aktiv jo-material matet fillimisht me koston.

Mbajtja e mëposhme

Mbas njohjes fillestare, një aktiv jo-material mbartet me koston e tij minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Aktivët jo-materiale amortizohen me normën 15% mbi koston historike.

4.5. Aktive jo financiare

Vlerat kontabël të aktiveve jofinanciare të Shoqërisë janë rishikuar në datën e raportimit për të përcaktuar në qoftë se ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivit. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuarat monetare të ardhshme janë zbritur për vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për aktivin për të cilat vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme nuk janë rregulluar.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në qoftë se vlera e mbartur e aktivit apo pjesa e burimit të parave e kalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në të ardhura ose shpenzime.

4.6. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

4.7. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate dhe të ardhura nga veprimtari të tjera jooperative.

4.8. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Pagesat e bëra për qiratë operative njihen në të ardhura ose shpenzime në mënyrë lineare gjatë afatit të qirasë.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

